



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
___.01.2021

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR CAKTIMIN E PARTISË QË DO TË PROPOZOJË ANËTARIN E SHTATË TE KOMISIONEVE TË ZONA VE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021”

Referuar nenit 29 paragrafi 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet se anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kriterëve objektive të bazuara në:

- përzgjedhjen rastësore;
- shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor.

Komisioni Rregullator, për zbatimin e kriterëve ligjore të sipërcituara, me vendimin nr.5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, neni 4 i vendimit, ka përcaktuar procedurat për hedhjen e shortit, në seancë publike, ndërmjet partisë kryesore të shumicës parlamentare dhe partisë kryesore të opozitës parlamentare, si më poshtë:

- a) për efekt të shortit:
 - i. zonat e administrimit zgjedhor mbajnë numërtimin sipas përcaktimeve të vendimit të Rregullatorit;
 - ii. në KZAZ-të e ZAZ-ve me numër tek, anëtari i shtatë do të propozohet nga njëra prej partive që merr pjesë në short dhe në KZAZ-të e ZAZ-ve me numër çift, anëtari i shtatë do të propozohet nga partia tjetër;
- b) emrat e partive pjesëmarrëse në short shkruhen në shirita letre, të cilët mbyllen në dy gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë transparente;
- c) dy shirita letre ku në shiritin e parë shkruhet “KZAZ-të e numërtuara me numër tek” dhe në shiritin tjetër “KZAZ-të e numërtuara me numër çift”, mbyllen në dy gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë të dytë transparente;



- ç) një nëpunës i administratës së KQZ-së, tërheq njërën nga goglat që ndodhen në enën e parë;
- d) përfaqësuesi i partisë, emri i së cilës ndodhet në shiritin e letrës brenda goglës së tërhequr nga ena e parë, tërheq i pari njërën nga dy goglat në enën e dytë. Në mungesë të përfaqësuesit të partisë përkatëse, Komisioneri cakton një punonjës të administratës për të tërhequr njërën nga goglat në enën e dytë;
- dh) partisë politike, përfaqësuesi i së cilës tërhoqi goglën në enën e dytë, i lind e drejta të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve sipas përcaktimit në shiritin e letrës që ndodhet brenda goglës së tërhequr (tek ose çift).

Në bazë të parashikimeve të paragrafit 7, të dispozitës së sipërcituar, Komisioneri shpall me vendim rezultatin e shortit për caktimin e partisë politike që do të propozojë anëtarin e shtatë KZAZ-ve.

Për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, në bazë të përcaktimeve të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 40, datë 23.12.2020 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, anëtari i shtatë i KZAZ-ve do të propozohet në gjysmën e tyre nga Partia Socialiste e Shqipërisë, kurse në gjysmën tjetër nga Partia Demokratike, sipas rezultatit të shortit që do të hidhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Për sa më lart, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore
Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor
Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2021

Nr:

PROJEKTVENDIM

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR CAKTIMIN E PARTISË QË DO TË PROPOZOJË ANËTARIN E SHTATË TE KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 4, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr.5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”,

V Ë R E N

Referuar nenit 29 paragrafi 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet se anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kritereve objektive të bazuara në:

- përzgjedhjen rastësore;
- shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor.

Komisioni Rregullator, për zbatimin e kritereve ligjore të sipërcituara, me vendimin nr.5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, neni 4 i vendimit, ka përcaktuar procedurat për organizimin në seancë publike të hedhjes së shortit ndërmjet partisë së parë të shumicës parlamentare dhe partisë së parë të opozitës parlamentare. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin e shortit.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 40, datë 23.12.2020 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve në zgjedhjet për Kuvendin e



Data: Janar 2021

Nr.

Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021

Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, ka përcaktuar se anëtari i shtatë do të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, parti e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike, parti e parë e opozitës parlamentare, sipas rezultatit të shortit që do të hidhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, më datë....., në seancë publike organizoi hedhjen e shortit ndërmjet Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë Demokratike, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 4, të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, miratuar nga Komisioni Rregullator me Vendimin nr. 5, datë 20.11.2020.

Sipas rezultatit të shortit, Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve me numër, dhe Partia Demokratike do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve me numër

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 4, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr.5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”,

VENDOSA:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve të renditura me numër _____, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Partia Demokratike do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve të renditura me numër _____, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: Janar 2021

Nr.

Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021